

# WICHTIGE INFORMATION!

ALBANISCH

## Shumë të nderuar prindër. Të nderuar kujdestar

Të Hënën, më 21.Mars 2022 do të ketë përsëri një **protestaksion** ndërmjet kohës prej **orës 8:30-10:30** nga e cila mund të ketë ndikim nga institucionet të fillimit arsimor të fëmijës suaj. Prandaj, do të ketë kufizime në operacione pasi që do ketë më pak staf personal.

Në institucionet arsimore fillore dhe qendrat e kujdesit passhkollor po bëhet punë e vlefshme edukativoarsimore. Mijëra njerëz të përkushtuar bëjnë gjëra të jashtëzakonshme në mënyrë që fëmija juaj të marrë mundësitë më të mira të mundshme arsimore kurse prindërit të kenë mundësi të kryejnë punët profesionale të tyre me qetësi.

youunion \_ Daseinsgewerkschaft (Disajn i Sindikatave) ka vënë në dukje prej vitesh se kushtet e kornizës nuk përshtaten më me kërkesat e ndryshme. Prandaj, ne po bëjmë thirrje për një **ofensivë arsimimi** për të marrë **më shumë staf personal** në grupet e fëmijëve të vegjël, kopshtet dhe qendrat e kujdesit passhkollor. Kjo është mënyra e vetme për të **përmirësuar kushtet e punës** për të mirën e të gjithëve.

Qofshin asistentë, pedagogë dhe edukatorë specialë, trajnerë gjuhësh, ndihmëspedagogë apo drejtues - të gjithë së bashku me ju u përballën me sfida të mëdha gjatë viteve të pandemisë dhe garantuan vazhdimin e operacioneve në kushte shumë të vështira. **Bëhet fjalë për fëmijën tuaj dhe kuadrin që mund të ofrohet për të siguruar zhvillimin më të mirë të mundshëm.**

Ne gjithashtu vlerësojmë mbështetjen tuaj në këtë ditë. Ejani në demonstratën tonë para Ministrisë së Arsimit (Minoritenplatz 5, 1010 Vjenë) dhe luftoni për përmirësime së bashku me ne.

**Faleminderit për mirëkuptimin,  
ndihmën dhe solidaritetin tuaj.**

**youunion**  
Die Daseinsgewerkschaft